



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 4.9.2023

Nr: 748

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË POLITIKE “PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË”, PËR  
REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR NË ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR TË BASHKISË  
KUKËS TË DATËS 24 SHTATOR 2023**

Sot më datë 4.9.2023, në seancë publike, mora në shqyrtim kërkesën e paraqitur në datë 31.8.2023 nëpërmjet portalit elektronik të partive politike (Modulit) dhe subjekteve zgjedhore, me:

**Kërkues:** Partia politike “Partia Socialiste e Shqipërisë”, me kryetar z. Edi Rama.

**Objekti:** Regjistrimi i partisë politike “Partia Socialiste e Shqipërisë”, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 Shtator 2023

**Baza ligjore:** Neni 64 i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Në përfundim të shqyrtimit administrativ

V Ë R E J:

Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 186, datë 11.8.2023, ka caktuar datën 24 Shtator 2023, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve të pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës.

“Partia Socialiste e Shqipërisë”, nëpërmjet kryetarit të saj z. Edi Rama, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, që do të zhvillohen më datë 24 Shtator 2023.

Data: 4.9.2023 Nr: 748  
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike “Partia Socialiste e Shqipërisë”, për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës të datës 24 Shtator 2023”

Nga partia politike “Partia Socialiste e Shqipërisë” është paraqitur dokumentacioni vijues:

- a) Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 28.8.2023, nëpërmjet të cilit vërtetohet se “Partia Socialiste e Shqipërisë”, me iniciale “PS”, me kryetar z. Edi Rama, rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre;
- b) Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02);
- c) Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike (Model KQZ-04-03).

Nga dokumentacioni si më sipër, si dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

- a) Emri zyrtar i partisë është “Partia Socialiste e Shqipërisë” me shkronja nistore “PS”, me adresë Sheshi Austria, nr. 91, Tiranë;
- b) Kryetari i partisë është z. Edi Rama, me adresë, Sheshi Austria, nr. 91, Tiranë;
- c) Financieri i partisë është znj. Dhurata Isufaj, me adresë Sheshi Austria, nr. 91, Tiranë;
- ç) Personi përgjegjës për komunikim me KQZ-në është z. Fatmir Muçaj, me adresë, Sheshi Austria, nr. 91, Tiranë;
- d) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Kërkesa e paraqitur nga “Partia Socialiste e Shqipërisë”, respekton afatin kohor të parashikuar në nenin 64, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Dokumentacioni bashkëshoqërues kërkesës, i paraqitur nga “Partia Socialiste e Shqipërisë”, është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64, pika 2 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, nenin 64, pika 2 dhe nenin 92 /2, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe udhëzimit nr. 1, datë 18.1.2023, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”, dhe vendimit nr. 28 datë 16.8.2023 të Komisionit Rregullator “Për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për Kryetar në Bashkinë Kukës, që do të zhvillohen më datë 24 Shtator 2023”,

## **VENDOS:**

1. Regjistrimin e partisë politike “Partia Socialiste e Shqipërisë”, me kryetar z. Edi Rama, me shkronjat nistore “PS”, si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 Shtator 2023.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**